

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Elementet e njohurive të
Auditimit të Brendshëm

B1

ID Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË
TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 25.01.2025

Pjesa	Maksimumi i dhënë	Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK PIKËT E DHËNA
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Gjithsej	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Cili nga opsionet e mëposhtme është kontribuuesi kryesor në problemet e qeverisjes së korporatave?
 - a) **Ndarja e pronësisë nga kontrolli.**
 - b) Kontrolli mbi procesin e përfaqësuesit.
 - c) Marrëdhëniet aksionar - agjent.
 - d) Aksionarët të cilët konsiderohen vetëm si investitor dhe jo si pronar.

2. Cili nga pikat e mëposhtme mund të vijë pasi të ekzistojnë tre pikat e tjera në një përpjekje për të përmirësuar qeverisjen e korporatave?
 - a) Ndryshimi i përbërjes së bordeve të drejtorëve.
 - b) Ndryshimi i strukturës së bordit të drejtorëve.
 - c) **Aksionarët duke marrë një rol aktiv në qeverisje.**
 - d) Ndryshimi i funksionimit të bordeve të drejtorëve.

3. Menaxhmenti i korporatës shpesh vë në dyshim vlerën e pajtueshmërisë me ligjet, rregullat dhe rregulloret në lidhje me:
 - I. Kostot direkte
 - II. Përfitimet e drejtpërdrejta
 - III. Kostot indirekte
 - IV. Përfitimet indirekte
 - a) I dhe II
 - b) I dhe IV
 - c) II dhe III
 - d) **III dhe IV**

4. Cila nga këto që vijon është funksioni themelor i qeverisjes së korporatave?
 - a) Sigurimi i strukturës dhe burimeve të organizatës
 - b) Vendosja e rregullave dhe procedurave
 - c) **Monitorimi i vazhdueshëm i performancës së organizatës**
 - d) Caktimi i të drejtave dhe përgjegjësive për të gjithë punonjësit

5. Cili nga opsionet e mëposhtme NUK është një shembull i dilemës etike me të cilën përballet një menaxher i biznesit që përfshin një konflikt midis:
 - a) Pjesës kundrejt tërësisë.
 - b) Individit kundrejt organizatës
 - c) Organizatës kundrejt shoqërisë.
 - d) **Individit përkundrejt familjes.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

6. Qebrisja e korporatës ka një ndikim të fuqishëm në aftësinë e firmave që të :
 - a) Mbijetojnë vazhdimisht
 - b) Të ndihmoj në rritjen e firmës
 - c) Të krijoj avantazh konkurrues**
 - d) Të performoj më mirë

7. Përgjegjësia sociale duhet të konsiderohet si një faktor në cilën nga këto?
 - a) Planifikimin operacional
 - b) Planifikimin strategjik**
 - c) Planifikimin funksional
 - d) Planifikimin e njësisë së biznesit

8. Një mjet që në përgjithësi NUK përdoret për të menaxhuar rrezikun subjektiv është:
 - a) Marrja e më shumë informatave
 - b) Diskutim ne grup
 - c) Identifikimi dhe analizimi sistematik i metodave të përshtatshme për trajtimin e rreziqeve
 - d) Ulje e nivelit të ashpërsisë**

9. Cila nga praktikrat e mëposhtme financiare dhe të kontabilitetit NUK është rrezik për korporatat publike?
 - a) Inxhinieria financiare.**
 - b) Menaxhimi i fitimeve.
 - c) Kontabiliteti kreativ.
 - d) Llogaritë jashtë-bilancore.

10. Cila nga opsionet e mëposhtme klasifikohet si rrezik strategjik i menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjeve (ERM)?
 - a) Rreziku i tregut
 - b) Fatkeqësitë natyrore
 - c) Rreziku i reputacionit**
 - d) Rreziqet që ndërlidhen me sistemet, proceset dhe teknologjinë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

11. Cila nga rezultatet e mëposhtme që rezulton nga auditimi i produkti është e vështirë për një menaxher të produktit të trajtojë?
 - a) Për të vazhduar me produktin aktual.
 - b) Për të përmirësuar produktin aktual.
 - c) Për të ndërprerë produktin aktual.**
 - d) Për të modifikuar produktin aktual.

12. Rrjedhjet negative të parasë ndodhin në cilën nga fazat e mëposhtme të ciklit jetësor të produktit?
 - a) Në hyrje**
 - b) Në rritje
 - c) Në pjekuri
 - d) Në rënie

13. Cili nga standardet e mëposhtëm ISO shprehimisht NUK kërkon një auditim zyrtar?
 - a) ISO 14001 - Menaxhim Mjedisi.
 - b) ISO 9001 - Menaxhim i Cilësisë.
 - c) ISO 26000 - Përgjegjësia sociale.**
 - d) ISO 50001 - Menaxhimi i energjisë.

14. Cili nga sa vijon është një model i udhëheqjes që përshkruan marrëdhëniet midis stileve të udhëheqjes dhe situatave specifike organizative?
 - a) Qasja e kontigjencës.**
 - b) Qasja e sjelljes.
 - c) Qasja e tipareve.
 - d) Qasja organizative.

15. Cili nga llojet e mëposhtëm të udhëheqësve sqaron rolin dhe kërkesat e detyrave të vartësve?
 - a) Transaksional.**
 - b) Karizmatik.
 - c) Transformuese.
 - d) Mbështetës.

16. Cila nga fazat e mëposhtme të zhvillimit të ekipit shoqërohet me konflikte dhe mosmarrëveshje?
 - a) Kryerja.
 - b) Normimi
 - c) Mësymja**
 - d) Formimi

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

17. Koha midis vendosjes së një porosie dhe asaj kur pranohet nga klienti njihet si:

- a) Koha e arritjes
- b) Koha e ciklit të porosisë**
- c) Koha e transportit
- d) Koha e porositjes

18. Kostoja e mbajtjes së inventarit është e barabartë:

- a) Inventari mesatar në Euro x çmimi i njësisë x kostoja mbajtëse në vit
- b) Inventari mesatar në njësi x çmimi i njësisë x kostoja mbajtëse në vit**
- c) Saldo përfundimtare e inventarit në Euro x çmimi i njësisë x kostoja mbajtëse në vit
- d) Saldo përfundimtare e inventarit në njësi x çmimi i njësisë x kostoja mbajtëse në vit

19. Një kompani e shërbimit mban të dhënat e saj të kontabilitetit mbi bazën e parave të gatshme. Gjatë vitit 2012, kompania mbledhi €600,000 nga klientët. Informacioni i mëposhtëm është gjithashtu në dispozicion:

	Fillim të vitit	Fund të vitit
Llogaria e arkëtueshme	€ 120,000	€ 180,000
E ardhura e pa fituar	-	€ 15,000

Cila ishte shuma e të ardhurave të shërbimit të fituara për vitin në bazë akruale?

- a) €525,000.
- b) €555,000.
- c) €675,000.
- d) €645,000.**

Mbledhja e parasë së gatshme (€600,000) + Rritja e arkëtimeve (€60,000) - Rritja e të ardhurave të pa fituara (€15,000) = €645,000

20. Një sistem i planifikimit të kërkesave materiale (MRP) do të ishte më i vështirë të aplikohet për një prodhues i cili:

- a) Përdor relativisht pak materiale direkte
- b) Ka kohë të gjatë të strukturimit të pajisjeve prodhuese
- c) Është në një industri shumë të paqëndrueshme**
- d) Përballon kosto të larta joproduktive

21. Cilët nga faktorët strategjikë të mëposhtëm luajnë rol në përcaktimin e një çmimi bazë?

- I. Objektivat e kompanisë
- II. Strategjia e pozicionimit
- III. Strategjitë e reja të çmimeve të produkteve
- IV. Dallimet në cilësi dhe çmime

- a) I dhe II
- b) II dhe III
- c) III dhe IV
- d) I, II, III dhe IV**

22. Nëse çdo gjë tjetër është e barazuar, bilanci i parave të gatshme të raportuara në pasqyrën bankare të një klienti do të jetë më i vogël se bilanci i treguar në të dhënat e vetë klientit nëse ka:

- a) Para në tranzit.**
- b) Çeçe të papaguara
- c) Pagesat e interesit për klientin që nuk janë regjistruar ende në librat e klientit.
- d) Kredi në llogarinë e klientit që përfshijnë gabimisht depozitat nga një klient tjetër.

23. Cili nga sa vijon është përkufizimi i termit "kosto e konvertimit" në një mjedis prodhimi?

- a) Materiali direkt plus shpenzimet e përgjithshme të prodhimit.
- b) Puna direkte plus shpenzimet e përgjithshme të prodhimit.**
- c) Puna direkte plus materiali direkte.
- d) Materiali direkte plus materiali indirekte.

24. Paga e inxhinierit të prodhimit duhet të klasifikohet si:

- a) Shpenzim i përgjithshëm i prodhimit**
- b) Kosto e punës direkte
- c) Kosto variabile.
- d) Kostoja e inxhinierizuar.

25. Cili nga sa vijon NUK është një nga parimet e menaxhimit të përgjithshëm të cilësisë (TQM)?

- a) Bëni mirë herën e parë
- b) Përqendrohuni tek klienti
- c) Ndërtoni punë ekipore dhe fuqizim
- d) Përpikuni për zero defekte**

26. Menaxhimi i përgjithshëm i cilësisë në një mjedis prodhimi ilustron më së miri nga:

- a) Identifikimi dhe përpunimi i defekteve të prodhimit përpara shitjes
- b) Dizajnimi i produktit për të minimizuar defektet**
- c) Kryerja e inspektimeve për të izoluar defektet sa më shpejt që të jetë e mundur
- d) Bërja e rregullimeve të makinerisë në mënyrë periodike për të zvogëluar defektet

27. Për shkak të numrit të madh të faktorëve që mund të ndikojnë në kërkesën për produktin e ri, bashkëveprimet midis këtyre faktorëve dhe mundësitë që lidhen me vlera të ndryshme të këtyre faktorëve, departamenti i marketingut do të dëshironte të zhvillonte një model të kompjuterizuar për projektimin e kërkesës për këtë produkt. Duke përdorur një procedurë të numrit të rastit për të gjeneruar vlera për faktorët e ndryshëm, do të jetë në gjendje të vlerësojë shpërndarjen e kërkesës për këtë produkt të ri. Kjo metodë e vlerësimit të shpërndarjes së kërkesës për produktin e ri quhet:
- a) **Simulimi i Monte Carlos**
 - b) Programimi linear
 - c) Analiza e korrelacionit
 - d) Analiza diferenciale
28. Një nga gjërat më të rëndësishme që menaxherët mund të bëjnë për organizatën e tyre është:
- A. Të bisedojnë me punonjësit e tyre.
 - B. **Të krijojnë një mjedis besimi dhe sinqeriteti.**
 - C. Të dëgjojnë punonjësit e tyre.
 - D. Të sigurohen që prodhimi të mbetet i lartë.
29. Cili nga opsionet e mëposhtme është problemi kryesor i rregullatorëve dhe autoriteteve qeveritare kur hartohen masat e politikave qeveritare?
- A. Rregullimi i tepërt.
 - B. Ligje të pazbatueshme.
 - C. **Mosbalancimi mes kostove dhe përfitimeve.**
 - D. Parandalimi i sjelljes së pandershme.
30. Tërësia e vendimeve dhe veprimeve të përdorura për të formuluar dhe zbatuar strategji që sigurojnë një përshtatje të plotë mes organizatës dhe mjedisit të saj në mënyrë që të arrihen qëllimet organizative njihet si:
- A. Formulimi i strategjisë.
 - B. Planifikim strategjik.
 - C. **Menaxhimi strategjik.**
 - D. Zbatimi i strategjisë.
31. Gjatë cilës nga fazat e mëposhtme të zhvillimit të ekipit shfaqet uniteti i ekipit?
- a) Kryerjes
 - b) Mësymjes
 - c) Formimit
 - d) **Normimit**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

32. Për disa vite, departamenti i auditimit të brendshëm kishte përdorur softuer të bazuar në karaktere në llaptopët e tyre për të kryer auditimet e caktuara. Pas kryerjes së një hulumtimi të gjerë, drejtori i departamentit të auditimit të brendshëm përcaktoi që një ndryshim në softuer me një ndërfaqe grafike të përdoruesit (GUI) do të ishte i dobishëm për departamentin. Kur tema u njoftua në një mbledhje të rregullt departamentesh, disa nga personeli i departamentit të auditimit të brendshëm shprehën shqetësimin për kohën shtesë që do të duhej për të mësuar softuer të ri, ngadalësinë e softuerit GUI dhe faktin që programi i bazuar në karakter ishte tashmë i njohur për ta dhe nuk kishte shkaktuar probleme. Cila nga qasjet e mëposhtme do të ishte më e përshtatshme për të ndryshuar qëndrimet e personelit të auditimit?

- I. Informoni personelin e auditimit për hulumtimin e përfunduar
- II. Impononi vendimin në personelin e auditimit
- III. Ofroni pushime dhe fonde të departamenteve për trajnime
- IV. Negocioni datat për prezantimin e softuerit
- V. U thoni punonjësve që nëse nuk e pranojnë programin e ri, ata mund të pushohen

- a) I, II, III dhe IV
- b) II, III, V
- c) II, IV, V
- d) I, III, IV**

33. Një auditor i brendshëm po kryen një rishikim operacional që prek disa njësi të ndryshme funksionale. Auditori beson se procesi në shqyrtim mund të përmirësohet, por menaxherët operues janë rezistentë ndaj sugjerimeve për ndryshim. Ekzistojnë disa metoda që auditori mund të përdorë për të kapërcyer rezistencën e menaxherëve operues. Identifikoni teknikën që do të ofroj probabilitetin më të lartë të suksesit me efektet më të pakta negative.

- a) Negocimi me menaxherët operues
- b) Detyrimi i menaxherëve përmes kërcënimeve
- c) Bashkëpunim duke i' u drejtuar secilit menaxher individualisht
- d) Pjesëmarrja nga menaxherët në procesin e vendimit**

34. Auditorët e brendshëm mund të konsiderohen si agjentë kryesorë për ndryshime brenda një organizate. Cila nga sa vijon NUK është një mënyrë e mirë për të promovuar këtë koncept?

- a) Një broshurë që përshkruan se çfarë mund të bëjë auditimi i brendshëm dhe kualifikimet e auditorëve
- b) Pyetësorët pas auditimit për të marrë informacione se si auditorët perceptojnë operacionin e auditimit
- c) Një direktivë nga menaxhmenti i lartë, që thotë se auditorët e brendshëm do të përdoren për të gjitha projektet e përmirësimit të procesit**
- d) Buletin që nxjerrë në pah aplikacione të përhapura ose universale të gjetjeve të auditimit

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

35. Përzgjedhja dhe zbatimi i kontroleve të sigurisë për të zvogëluar rreziqet në një nivel të pranueshëm i referohen cilit opsion nga të mëposhtmet?
- A. Analiza e rrezikut.
 - B. Vlerësimi i rrezikut.
 - C. Zbutjes së rrezikut.**
 - D. Menaxhimi i rrezikut.
36. Shuma e rrezikut që një organizatë mund të trajtojë duhet të bazohet në cilën nga opsionet e mëposhtme:
- A. Nivelin teknologjik.
 - B. Nivelin e përbalueshëm të rrezikut
 - C. Nivelin e matshëm të rrezikut
 - D. Nivelin e pranimi të rrezikut**
37. Një rregullim i periudhës paraardhëse ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave të një periudhe më të hershme sepse:
- A. Është mënyra e vetme për të rregulluar një gabim në pasqyrat financiare të mëparshme.
 - B. Pasqyra e të ardhurave e periudhës aktuale përshkruan vetëm fitimet e rregullta dhe të përsëritura të biznesit që bazohen në operacione normale.
 - C. Pasqyra e të ardhurave e periudhës aktuale përshkruan ngjarje ose vlerësime që lindin vetëm në periudhën aktuale.**
 - D. Pasqyra e të ardhurave e periudhës aktuale pasqyron aftësinë për krijimin e të ardhurave në për një afat të gjatë kohor të ndërmarrjes.
38. Ndryshimi i paautorizuar i regjistrave në internet mund të parandalohet duke përdorur:
- a) Verifikimin me çelës
 - b) Kontrollat e sekuencës kompjuterike
 - c) Përputhja e kompjuterit
 - d) Kontrollat e hyrjes në bazën e të dhënave**
39. Për të qenë në pajtueshmëri me parimin e përputhjes, kosto e shërbimeve të punës të një punonjësi që merr pjesë në prodhimin e një produkti normalisht duhet të ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën:
- A. Kryhet puna
 - B. Punonjësi paguhet.
 - C. Produkti është përfunduar.
 - D. Produkti shitet.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

40. Aksionet preferenciale dhe të zakonshme ndryshojnë në atë që:

- a) Dështimi për të paguar dividendët në aksione të zakonshme nuk do ta detyrojë firmën në falimentim ndërsa mos pagimi i dividendëve në aksionet preferenciale do ta detyrojë firmën në falimentim
- b) Dividendët e aksioneve të zakonshme janë në shumë fikse ndërsa dividendët e aksioneve preferenciale nuk janë
- c) Aksionet preferenciale kanë një përparësi më të lartë se aksionet e zakonshme në lidhje me fitimet dhe pasuritë në rast të falimentimit**
- d) Dividendët e aksioneve preferenciale janë të zbritshëm si shpenzim për qëllime tatimore ndërsa dividendët e aksioneve të zakonshme nuk janë

41. Informacioni i pjesshëm i bilancit për një kompani për vitet që përfundojnë më 31 Dhjetor 2017 dhe 2018 janë:

	31.12.2018	31.12.2017
Pasuritë rrjedhëse (përveç parasë)		
Llogaritë rrjedhëse	€20,000	€5,000
Stoqet	€50,000	€14,000
Shpenzimet e parapaguara	€3,000	€6,000
Detyrimet rrjedhëse		
Llogaritë e pagueshme	€32,000	€16,000
Tatimi i pagueshëm në pronë	€4,000	€3,000

Kapitali punues u rritë në vitin 2018 me €12,000. Ndryshimi i parave të gatshme në vitin 2018 ishte:

- a) €12,000
- b) €43,000
- c) € (36,000)
- d) € (19,000)**

Ndryshimi në para = Ndryshimi në kapitalin punues - Ndryshimi në pasuritë rrjedhëse jo-monetare + Ndryshimi në detyrimet rrjedhëse

Ndryshimi në para = 12,000 - (15,000 + 36,000 - 3,000) - (16,000 + 1,000) = - 19,000€

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

42. Një kompani kishte 500 njësi në stoqet fillestare që kushtonin 5 € për njësi. Më 1 mars, kompania bleu 300 njësi me një kosto prej 7€ secila. Më 1 shtator u blenë edhe 300 njësi të tjera. Gjatë vitit u shitën 700 njësi dhe saldo përfundimtare e stoqeve është €2,500. Nëse kompania përdor metodën (FIFO) të vlerësimit të stoqeve, atëherë kostoja për njësi e artikujve të blerë në 1 shtator, në centin më të afërt, ishte:

- a) 3.67€
- b) 6.00€**
- c) 6.67€
- d) 7.58€

$$2,500€ = 100\text{njs.} \times (7€) + 300\text{njs.} \times (\text{kosto e panjohur})$$

$$\text{Kosto e panjohur} = (2,500€ - 700€) / 300\text{njs.} = 6.00€$$

43. Një kompani është subjekt i pretendimeve nga garancionet e produkteve. Vlerësohet se ndoshta do të paguhet 1,000,000 deri 3,000,000 Euro. Asnjë vlerësim i humbjes brenda këtij intervali nuk ka më shumë gjasa për të ndodhur sesa çdo vlerësim tjetër. Kompania duhet:

- A. Të mos bëj asnjë shënim në ditar në këtë moment.
- B. Të shpalos vetëm një humbje të mundshme.
- C. Të shtyjë llogaritjen e një humbje prej 1,000,000 deri në 3,000,000 euro në varësi të standardeve kombëtare të kontabilitetit të zbatueshme.
- D. Të llogarisë një humbje prej 1,000,000 deri në 3,000,000 euro në varësi të standardeve kombëtare të kontabilitetit të zbatueshëm.**

44. Në dhjetor 2021, janë printuar disa katalog për t'u përdorur në një promovim special në janar 2022. Katalogët u dorëzuan nga firma e printimit më 13 dhjetor 2021, me një faturë prej 70,000€ të bashkangjitur. Pagesa është bërë në janar, 2022. 70,000€ duhet të raportohen si një kosto e shtyrë në datën e bilancit të gjendjes më 31 dhjetor 2021 për shkak të:

- A. Parimit të përputhjes/harmonizimit.**
- B. Parimit të realizimit të të ardhurave.
- C. Parimit të objektivitetit.
- D. Parimit të kostos.

45. Një organizatë ofron kushtet e kreditit të klientëve të saj prej 5/10 neto 20. Një e treta e klientëve marrin zbritjen e parave të gatshme dhe klientët e tjerë paguajnë në ditën 20. Mesatarisht, 20 njësi shiten në ditë, me çmim €10,000 secila. Shkalla e shitjeve është uniforme gjatë gjithë vitit. Duke përdorur një vit me 360 ditë, organizata ka ditë shitje të papaguara, deri në ditën më të afërt të plotë, të:

- a) 13 ditë
- b) 15 ditë
- c) 17 ditë**
- d) 20 ditë

Një - e treta e klientëve përfitojnë nga zbritja në para prej 5% dhe paguajnë në ditën 10. Dy të tretat e mbetura të klientëve paguajnë në ditën 20. Ditët mesatare të shitjeve të papaguara llogariten si:

Ditët e shitjeve të papaguara = $(1/3) \times (10 \text{ ditë}) + (2/3) \times (20 \text{ ditë}) = 17 \text{ ditë}$

46. Kostot e organizimit të një biznesi, përfshirë tarifat e avokatëve dhe kontabilistëve duhet të jenë:
- Kapitalizuar, por jo amortizuar, për shkak të jetës së pacaktuar të biznesit
 - Nuk janë regjistruar sepse ato janë shpenzime të organizuesit
 - Kapitalizuar dhe amortizuar gjatë jetës së tyre të dobishme, për të mos kaluar më shumë se 40 vjet.**
 - Kapitalizuar dhe shtyhet deri në likuidimin e biznesit
47. Nëse zhvlerësimi ishte mbivlerësuar gabim materialisht në vitin paraprak, korrigjimi në vitin pasardhës kur zbulohet gabimi do të përfshijë:
- Rritjen e fitimeve të raportuara për vitin aktual
 - Uljen e fitimeve të raportuara për vitin aktual
 - Rritjen e bilancit fillestar të fitimeve të mbajtura për vitin aktual**
 - Zvogëlimin e bilancit fillestar të fitimeve të mbajtura për vitin aktual
48. Cila nga sa vijon NUK është një ndryshore në studimin ndërkombëtar të Hofstede për kultura të ndryshme?
- Distanca e fuqisë
 - Orientimi politik**
 - Individualizmi-kolektivizmit
 - Shmangia e pasigurisë
49. Në regjistrimin e transaksioneve, cila nga të mëposhtmet përshkruan më mirë dallimin midis llogarive të shpenzimeve dhe llogarive të humbjeve?
- Humbjet janë ngarkesa të jashtëzakonshme ndaj të ardhurave ndërsa shpenzimet janë ngarkesa të zakonshme ndaj të ardhurave.
 - Humbjet janë zëra materiale ndërsa shpenzimet janë zëra jomaterialë.
 - Shpenzimet janë kosto të lidhura me të ardhurat, humbjet jo.**
 - Shpenzimet mund të parandalohen gjithmonë, ndërsa humbjet nuk mund të parandalohen kurrë.
50. Disa tregues ekonomikë e çojnë ekonominë në rimëkëmbje ose recesion, dhe disa e vonojnë atë. Një shembull i një variabëli të vonësës në zhvillim ekonomik do të ishte:
- Papunësia kronike.**
 - Porositë për mallra të konsumit dhe prodhues.
 - Ndërtimet e shumta të banesave/shtëpive.
 - Pritjet e konsumatorëve.